



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 1459 Prot

Tiranë, më 24/11/2023

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; Urdhrit të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të TKOBAP-së me nr.1850 prot datë 25.07.2014, **shpall audicionin e brendshëm për pozicionin e punës “Mjeshtër Vallesh (Korepetitor)” pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Audicioni do të zhvillohet më 27/12/2023, ora 11:00 në sallën e Sektorit të Valleve pranë TKOBAP.**

Të gjithë kandidatët e interesuar për këtë vend vakant duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit deri në datën **20/12/2023, ora 16:30** dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për shprehje interesi për pozicionin e punës “Mjeshtër Vallesh (Korepetitor)” pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.
2. Diploma e noterizuar për përfundimin e studimeve e larta (Akademia e Arteve) dega Koreografi.
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit.
4. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 30 viteve të fundit e certifikuar me programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë imazhin artistik brenda dhe jashtë vendit etj), dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar sa më lart dhe eksperiencën e gjatë në drejtimin e grupit te valltarëve si udhërrëfyes skenik gjatë gjithë jetës artistike.
5. Referenca artistike.

*Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumentacionit si më lart cituar sjell skualifikimin e kandidatit.

Gjatë audicionit kandidatët pjesëmarrës do të vlerësohen për kërkesat që duhet të kërkojë një Mjeshtër Vallesh (në teori dhe praktikë) për vallet sipas krahinave.

Programi artistik:

1. Vallja “Te Burimi”
2. Vallja “Ditë feste në Tiranë”
3. Vallja “Shqipe”.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

